

KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

FTESË PUBLIKE PËR BASHKËPUNIM DHE EKSPERTIZË NGA ORGANIZATAT DHE AGJENCITË NDËRKOMBËTARE TË INTERESUARA SI DHE EKSPERTË DHE PROFESIONISTË NDËRKOMBËTARË DHE SHTETAS SHQIPTARË JASHTË VENDIT

Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian” është ngarkuar nga Kuvendi i Shqipërisë për drejtimin e një reforme të dedikuar dhe gjithëpërfshirëse, të fokusuar në 3 fusha kyçe të ndërhyrjes: 1) mirëqeverisja, 2) sundimi i ligjit dhe 3) antikorrupsioni (Për më tepër, shihni bashkëlidhur Rezolutën, Vendimin nr. 50/2024 dhe Vendimin nr. 53/2024).

Në kuadër të zbatimit të qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së Komisionit për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe objektiv konform standarteve më të mira ndërkombëtare dhe në linjë me rekomandimet e partnerëve tanë strategjik (BE-në dhe SHBA-në), Komisioni shpreh kënaqësinë dhe interesin t’ju drejtohet me një **Ftesë publike për bashkëpunim** të gjithë organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të ndryshme, të specializuara në fushat përkatëse, që veprojnë brenda dhe jashtë vendit, si dhe individëve, ekspertë ndërkombëtarë dhe shtetas shqiptar jashtë vendit me përvojë të spikatur, në fushat objekt pune të Komisionit, që të shprehin interesin për të ofruar asistencë dhe ekspertizë në 3 fushat objekt pune të këtij komisioni dhe për përfshirje aktive në nivel ekspertësh ose dhe në Sekretariatit Teknik, në tryezat e debatit publik si dhe për të kontribuar me ekspertizën e tyre në procesin e punës që do të bashkërendojë Komisioni me Grupin e Ekspertëve, që do të ngrihet pranë këtij komisioni.

Adoptimi i praktikave/eksperiencave më të mira ndërkombëtare dhe kontributi me ekspertizë nga të gjithë aktorët pjesëmarrës, në nivel ndërkombëtar e kombëtar, do siguronte instalimin e një procesi transparent, të integruar dhe transversal, rezultati i të cilit do i shërbejë konsolidimit, avancimit e njëkohësisht pavarësisë, paanësisë, llogaridhënies, cilësisë dhe efikasitetit të shtetit të së drejtës, mirëqeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit në vendin tonë.

Për çdo komunikim të mëtejshëm, ju ftojmë të na kontaktoni në adresën elektronike: KomisioniPosacem@parlament.al.